



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.214/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret : Bujar Muzaqi kryesues, Skender Çoçaj, dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatoret dhe Intelektualet, me seli në Komuna Prishtinë, kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 29.01.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar, ankesa e Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatoret dhe Intelektualet, me seli në Komuna Prishtinë, Anr.214/2025 datë 27.01.2025.

II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i gjelbëri më lartësi prej 10,000.00 Euro (dhjetëmijë) Euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 27.01.2025 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Koalicioni AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatoret dhe Intelektualet, në të cilën theksohet se Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Lista GUXO dhe lista Alternativa, ka mbajtur fushatën zgjedhore në qytetin e Deçanit, përkatësisht në shtëpinë e kulturës "Jusuf Gërvalla", prej orës 17:00.

Më tej në ankesë thuhet se gjatë mbajtjes së fushatës politike, kandidatja për deputete nga radhët e listës Guxo Donika Gërvalla Schwartz, dhe kandidati për kryeministër nga Subjekti Politik LVV Albin Kurti, në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, kanë përdorur gjuhë të papërshtatshme gjatë fjalimit të tyre.

Sipas parashtuesit të ankesës gjatë këtij fjali, Donika Gërvalla Schwartz, duke aluduar për Ramush Haradinaj, të njëjtin e quan "generalë të vetëshpallur" (në shumës), e më pas vazhdon e njëjtë vazhdon "prandaj unë mendoj që aq më pak meriton respekt kush sakrificën personale apo familjare e përdor për arsyetim për krim për korruption, për vrasje apo mashtrim",

Si provë ka bashkangjitur linkun <https://klankosova.tv/gervalla-fyen-graden-e-haradinajt-ne-luftten-clirimtare-e-quan-gjeneral-te-vetëshpallur/>

Provë: <https://www.facebook.com/donikagervallakosova/videos/2331819440527815>

Ankuesi theksuar se deklaratat e bëra nuk janë asgjë tjetër veçse një tentativë për të manipuluar opinionin publik, ku shihet qartë se Shwarc, e akuzon liderin e një partie opozitare për vrasës dhe kriminel. Një gjuhë të tillë e njëjtë por edhe subjekti politik Vetëvendosje e kanë përdorur në vazhdimesi që nga fillimi i fushatës, duke i quajtur edhe banditë. Lidhur me këtë deklarate ka reaguar edhe Organizata e Veteranëve të Luftës Çlirimtare të Kosovës në Pejë, duke theksuar se "ta quash një komandant të betejave më të ashpra të luftës çlirimtare 'gjeneral të vetëshpallur' është jo vetëm një gjenieshtë e turpshme, por edhe një përdhosje e sakrificës së mijëra dëshmorëve dhe luftëtarëve të UÇK-së"

Provë: https://telegrafi.com/e-quajti-ramush-haradinajn-gjeneral-te-vetëshpallur-ovl-uckne-pejereagongervalles/?utm_campaign=dhjetor&utm_medium=organikpost&utm_source=facebook.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 28.01.2025 Subjekti Politik LVV, ka theksuar se konsiderojnë se ankesa është e pabazuar. Sa i përket kandidates për deputete Donika Görvalla, nga shqimi i linkut dhe provave të ofruara nga pretenduesit, në asnjë moment Görvalla nuk ka thënë "prandaj unë mendoj që aq më pak meriton respekt kush sakrificën personale apo familjare e përdorë për arsyetim për krim për korruption, për vrasje apo mashtrim".

Rrjedhimisht, pretendimi i parashtuesve është i pasaktë, i pavërtetë dhe si i tillë, është i paqëndrueshëm. Meqë parashtuesi nuk ka provuar se një deklaratë e tillë është bërë përmes linkut të një portali të bashkangjitur, atëherë konsiderojnë se Ankesa e tillë është e pabazuar.

Ndërsa sa i përket pjesës së parë të deklaratës së kandidates Gërvalla në të cilën pos tjerash, kinse ka quajtur z. Haradinaj "Gjeneral të vetëshpallur", sipas tyre në asnjë formë nuk cenon nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.11. LZP-së, përfaktin se deklarata e tillë, është në kuadër të rregullave zgjedhore dhe fryshtës së fushatës elektorale.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të parashtuesve lidhur me deklaratat e kandidatit për Kryeministër Albin Kurti kinse "respekt për pushkën që ia kanë kthyer Serbisë, por nuk ia bëjmë hallall për parët që ia kanë marrur popullit", e cila sipas pretenduesit aludohet për Ramush Haradinajn, Subjekti Politik LVV konsideron se Kurti në asnjë moment nuk ka përmendur z. Haradinaj në deklaratën e tillë, apo subjektin politik AAK.

Kësijoj deklarata e tillë është deklaratë e cila nuk bie në kuadër të nenit 34 paragrafi 1, nënparagrafi 1.11 përfaktin se kjo deklaratë nuk nxitë urrejtje e as nuk është gjuhë e papërshtatshme e as denigruese. E njëjtë është gjuhë e Cila është në përpunë me rregullat zgjedhore në fuqi.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shikimit të (linkut) të publikuar në rrjetin social Facebook - video incizimit të ofruar si provë materiale e cila është publikuar nga kandidatja përfaktin se deputete nga radhët e listës Guxo Donika Gërvalla Schwartz, shihet se kandidatja përfaktin se deputete nga radhët e listës Guxo Donika Gërvalla Schwartz ka përdorur gjuhë fyeze dhe denigruese duke nxitë urrejtje ndaj subjekteve

tjera politike në garë, në atë mënyrë që përderisa i ishte drejtuar elektoratit të saj në tubimin e Lëvizjes Vetëvendosje, Lista Guxo dhe lista Alternative me datë 26.01.2025 në Shtëpinë e Kulturës “Jusuf Gërvalla”, Komuna Deçan, përdorë fjalët “*prandaj unë mendoj që aq më pak meriton respekt kush sakrificën personale apo familjare e përdor për arsyetim për krim për korrupsion, për vrasje apo mashtrim*”, dhe “*Gjeneral të vetëshpallur*”, paneli vlerëson se është gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Andaj për Panelin përdorimi i një gjuhe të tillë nxit ose provokon, mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve dhe është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin në nen në mënyrë decidive thuhet se : “*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.

Paneli, pas shikimit shkresave të lëndës (linkut) të ofruar si provë materiale, nga e cila rrjedh se gjatë mbajtjes së fushatës politike, kandidatja për deputete nga radhët e listës Guxo Donika Gërvalla Schwartz, ka deklaruar se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe se të njëjtit kanë përdorur gjuhë të papërshtatshme gjatë fjalimit të tyre, vlerëson se është gjuhë denigruese, dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore.

Andaj për Panelin përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenit 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decidive thuhet se : “*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.

Në Nenin 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thuhet se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro. Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 9 nën paragrafi 9.1 Rregullës Nr.01/2024, ku në mënyrë decidive thuhet se “*subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në pesë dhjetëmijë (50,000.00)euro*”.

Sipas Panelit nga përbajtja e deklaratës së kandidates për deputete nga radhët e listës Guxo Donika Gërvalla Schwartz, konsiderohet gjuhë nxitëse dhe urrejtëse *kundrejt të tjerëve* në kuadër të fushatës zgjedhore dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore, konteksti dhe masa që i është drejtuar ka për qëllim të krijojë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe te përçarjes. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike dhe ne përgjithësi atmosfere destabiliteti. Përdorimi i gjuhës së tillë mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga kandidatët e lartëcekur është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngashëm, pjesëmarjen e subjektit të fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Pretendimi ankimor në përgjigjen në ankesë se parashtruesi nuk ka provuar se një deklaratë e tillë është bërë për mes linkut të një portali të bashkangjitur, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që një deklaratë e kandidates për deputete nga radhët e listës Guxo Donika Gërvalla Schwartz, është vërtetuar për mes (linkut) të publikuar në rrjetin social Facebook - video incizimit e cila është publikuar nga kandidatja për deputete nga radhët e listës Guxo Donika Gërvalla Schwartz.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr. 214/2025 më datë 29.01.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.